

Menstruation matters to everyone, everywhere

PERIODAT MUJORE NUK NDALONJË GJATË PANDEMIVE

“ËSHTË KOHA PËR VEPRIM”



Çdo 28 maj organizatat jofitimprurëse, agjencitë qeveritare, sektori privat, mediet dhe individët mblidhen për ta festuar Ditën e higjienës menstruale dhe angazhohen për rëndësinë e menaxhimit të mirë të higjienës menstruale (MHM).

Këtë vit, Dita e higjienës menstruale thekson që periodat mujore nuk ndalojnë gjatë kohës së pandemisë, „është koha për veprim“. Kjo temë e thekson emergjencën e punës kolektive që duhet bërë për të ndryshuar normat sociale negative rreth menstruacioneve dhe gjithashtu për përshejtimin e avancimit të përforcimit të grave dhe vajzave në zgjerimin e mundësive të tyre arsimore dhe ekonomike.

Më shumë se 800 milionë gra dhe vajza në ditë kanë menstruacione, por në mbarë botën ato përballen me pengesa në menaxhimin e drejtë të periodave të tyre. Stigmat dhe tabutë sociale rreth menstruacioneve shpesh herë u pamundësojnë grave dhe vajzave të shkojnë në shkollë dhe në punë. Mungesa e qasjes në produkte për higjienë menstruale, mungesa e infrastrukturës sanitare, si toaletet private dhe preparatet për larjen e duarve dhe mungesa e edukimit, mund të paraqesë një pengesë të madhe për gratë dhe vajzat që të mund të mirëmbajnë higjienën në vendin e punës.